

AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQERISE "A I" SHPK

Sot me daten 04 Dhjetor 2023, Z. Arben Isufaj, I biri I Islamit, lindur me date 16 Prill 1987, banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, vendosi te themeloje shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "A I" shpk, si me poshte vijon:

KREU I

EMRI I SHOQERISE, SELIA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI

NENI 1

EMRI I SHOQERISE

1.1. Emri i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar eshte "A I" SHPK (me poshte e quajtur Shoqeria").

NENI 2

SELIA

2.1. Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen: Rruga Teodor Keko, Pallati nr.1, Apartamenti nr.13, Shkalla nr.3, Kati 5, Zona Kadastrale nr.3866, Tirane, Shqiperi.

2.2. Asambleja e Pergjithshme mund te vendose mbi transferimin e selise se Shoqerise ne nje adrese tjeter. Organi administrues i Shoqerise mund te themeloje ose mbylle dege dhe/ose zyra perfaqesimi, brenda apo jashte Republikes se Shqiperise.

NENI 3

KOHEZGJATJA

3.1. Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore me afat te pacaktuar.

NENI 4

OBJEKTI I SHOQERISE

4.1. Shoqeria ka per objekt te saj kryerjen e te gjitha aktiviteteve qe nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar mund te ushtroje ne baze te legjislacionit shqiptar, brenda ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise, duke u fokusuar kryesisht ne:



a) Investimi ne instrument financiar (te cilet perfshijne pa kufizime titujt e pjesemarrjes ne kapitalin e shoqerive tregtare, titujt e borxhit, aksionet ose kuotat ne fonde investimesh etj), investimi ne pasuri te paluajtshme dhe ne asetete (te prekshme apo te paprekshme), si dhe

b) ofrimi i sherbimeve te konsulences per shoqerite e kontrolluara prej saj dhe/ose te trete (te cilet perfshijne pa kufizime konsulencen e natyres financiare, manaxheriale, ligjore, IT, zhvillim softwares etj.) ne perputhje me legjislacionin e zbatueshem ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte saj.

Gjithashtu, shoqeria mund te kryej cdo veprim, operacion apo transaksion tjeter komercial, industrial e financiar, te dobishem apo plotesues ndaj permbushjes se objektit te shoqerise, me kusht qe aktivitetet e mesiperme te mos jene ne kundërshtim dhe mos alterojne objektin paresor te veprimtarise se shoqerise.

Shoqeria mund të blejë dhe të shesë lirisht pjesë të kapitalit të shoqërive në pronësi në zbatim të legjislacionit shqiptar në fuqi.

4.2. Per permbushjen e objektit te saj Shoqeria mund te marre pjese dhe te jete e interesuar ne shoqeri dhe siper marrje, shqiptare apo te huaja, qe kryejne aktivitete te njejta, te ngjashme apo te lidhura me aktivitetin e saj ose te subjekteve pjesemarrase;

4.3. Shoqeria mund te veproje ne Shqiperi dhe jashte saj dhe te kryej cdo aktivitet tjeter te lidhur, ndihmes me qellim te permbushe ose te jete i dobishem per permbushjen e objektit ta saj.

KREU II

KAPITALI, KALIMI I KUOTAVE, ZMADHIMI DHE ZVOGELIMI I KAPITALIT

NENI 5

KAPITALI I SHOQERISE

5.1. Kapitali i Shoqerise eshte 100.000 (Njeqindmije) Leke, i barabarte me 1 (nje) kuote. Kapitali i Shoqerise nenshkruset menjehere dhe do te paguhet nga ortakut i vetem i shoqerise qe zoteron 100 % (njeqind per qind) te kontributeve ne kapitalin e shoqerise, perkatesisht: - Z. Arben Isufaj, i biri i Islamit, lindur me date 16 Prill 1987, banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me karten e identitetit me nr. Personal I70416086E.

5.2. Ne rast zmadhimi apo zvogelimi te kapitalit themeltar te Shoqerise, ortakut do te kete te drejten e nenshkrimit te zmadhimit apo zvogelimit te kapitalit

NENI 6

Fitimi

6.1. Fitimi neto nga aktiviteti i kesaj shoqerie, i perket ortakut te saj.



KREU III
DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 7
DETYRIMET NDAJ TE TRETEVE

7.1. Per detyrimet qe do krijohen ndaj paleve te treta, gjate zhvillimit te aktivitetit te kesaj shoqerie, do te pergjigjet vete shoqeria deri ne kufirin maksimal te kapitalit te saj.

NENI 8
MARREDHENIET E PUNES

8.1. Marredheniet e punes ne shoqeri dhe ne filialet e saj rregullohen nepermjet kontrates se punes.

NENI 9
PARIMET

9.1. Shoqeria e kryen veprimtarine e saj duke u mbeshtetur ne parime e likujditetit, sigurise dhe rentabilitetit.

NENI 10
TE DREJTAT E ORTAKUT

Te drejtat kryesore te ortakut jane:

- a). Pjesemarrje ne administrimin e shoqerise,
- b). pjesemarrje ne rezultatet e veprimtarise se shoqerise ne cdo forme dhe sasi ne perputhje me statutin e saj.
- c). te kerkoje ti jepen te gjitha informatat qe kane te bejne me gjendjen e tregtare te shoqerise dhe dokumentat e perpunuara te saj, si bilancet, llogarite ekonomike, etj.
- d). te emeroje dhe te shkarkoje perfaqesuesit e saj, punonjes, ekspert kontabel, drejtues Teknik.

NENI 11
DETYRIMET E ORTAKUT

Detyrimet e ortakut jane:

- a). Pjesemarrje ne administrimin e shoqerise, nepermjet organeve te krijuara prej tij
- b). ti jape shoqerise informacionet e nevojshme qe kane te bejne me ecurine e veprimtarise se saj

KREU III
ADMINISTRIMI

NENI 12
ADMINISTRIMI I SHOQERISE



12.1. Shoqeria administrohet nga nje apo me shume Administratore te cilet zgjidhen nga Asambleja e Pergjithshme per nje periudhe prej 5 (pese vjetesh). Administratori mund te rizgjidhet dhe shkarkohet ne cdo kohe nga Asambleja e Pergjithshme.

12.2. Administratori zoteron kompetenca te plota ne lidhje me administrimin e Shoqerise dhe mund te kryeje te gjitha aktet qe konsideron te nevojshme per realizimin e objektit te Shoqerise, pervec atyre qe ligji apo ky Akt Themelimi dhe Statut ia rezervon Asamblese se Pergjithshme apo organeve te tjera te Shoqerise.

12.3. Administratori vepron ne perputhje me politikat tregtare te vendosura nga Asambleja e Pergjithshme. Administratori eshte pergjegjes per veprimet e kryera ne administrimin e Shoqerise. Administratori mund te delegoje persona te trete per kryerjen e veprimeve dhe akteve qe kane te bejne me administrimin e Shoqerise, duke mbajtur pergjegjesi per te gjitha veprimet e kryera nga te tretet e deleguar per administrimin e Shoqerise.

12.4. Administratori do te veproje ne cdo kohe vetem ne interesin me te mire te Shoqerise. Ne rast konflikti interesi, Administratori do te njoftoje menjehere ortaket si dhe do te heqe dore nga cdo veprim qe lidhet me objektin e konfliktit te interesit deri ne marrjen e udhezimeve nga Asambleja e Pergjithshme.

12.5 Administratori i pare i Shoqerise do te jete: - Z. . Arben Isuifaj, lindur me date 16 Prill 1987, banues ne Tirane, identifikuar me karten e identitetit me nr. Personal I70416086E.

KREU IV

VITI FINANCIAR, LLOGARITE VJETORE, NDARJA E FITIMIT

NENI 13

VITI FINANCIAR

13.1. Viti Financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te cdo viti.

NENI 14

BILANCI VJETOR

14.1 Bilanci vjetor, pasqyrat financiare, inventari, raportet e Administratorit dhe te Ekspertit Kontabel te Autorizuar (nese jane emeruar) miratohen nga Asambleja e Pergjithshme. Administratori i paraqet per miratim Asamblese se Pergjithshme raportin mbi administrimin e Shoqerise si edhe llogarite vjetore.

14.2 Dokumentet qe kane te bejne me vitin financiar miratohen nga Asambleja e Pergjithshme brenda 6 (gashte) muajve nga mbyllja e vitit financiar.

NENI 15

DIVIDENDI

15.1. Pasi te jene permbushur kerkesat e percaktuara nga Ligji per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare, Shoqeria, me shumice te kualifikuar te votave se Asamblese te Pergjithshme, mund te vendose shperndarjen e dividendeve ne perputhje me te drejtat perkatese te ortakeve.

15.2. Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe nga te drejtat qe i bashkengjiten kuotave, te gjitha dividendet duhet te deklarohen dhe paguhen sipas shumave te paguara ne kuotat ne te cilat paguhet dividendi. Te gjitha dividendet do te shperndahen dhe paguhen ne menyre proporcionale me shumet e paguara mbi kuotat gjate cdo pjese ose pjeseve te periudhes ne te cilen paguhet dividendi.



KREU V
PRISHJA DHE LIKUJDIMI, LIGJI I ZBATUESHEM, ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

NENI 16
PRISHJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

16.1. Ne rastin e prishjes dhe likujdimi te Shoqerise do te zbatohen dispozitat e parashikuara ne ligjin per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare.

NENI 17
LIGJI I ZBATUESHEM

17.1. Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete Akt Themelimi e Statut dhe ligjin shqiptar. Per sa nuk eshte parashikuar ne kete akt, do te zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar ne fushen e shoqerive tregtare.

NENI 18
ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

18.1. Mosmarreveshjet qe mund te lindin ndermjet Shoqerise dhe ortakeve, apo ndermjet ortakeve dhe trashegimtareve te ortakeve ose ortakeve te tjere dhe/ose Shoqerise, qe kane per objekt te drejta te lidhura me Shoqerine, do te zgjidhen miqesisht ndermjet paleve te interesuara. Ne rast se palet nuk arrijne nje zgjidhje miqesore, Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane do te jete kompetente per zgjidhjen e mosmarreveshjeve.

NENI 20
DISPOZITA TE TJERA

20.1. Ky statut se bashku me ndryshimet dhe te gjitha dokumentat e tjera, raportet, komunikimet dhe procesverbalet e dhena nga shoqeria do te mbahen ne nje liber te vecante qe mbahet ne seline e shoqerise

20.2. Themeluesit e shoqerise, pasi e lexuan me vemendje akt themelimin dhe e gjeten ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, me vullnetin e tyre, e firmosen pa verejtje.

Ortaku I shoqerise

A I Shpk

ARBEN ISUFAJ

